

VENDIM
Nr. 269, datë 6.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 766, DATË 14.9.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE (ALCIRT)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 766, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronjat “d” dhe “e” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“d) Nxjerr rregullat e sigurisë së rrjeteve dhe të sistemeve kompjuterike shtetërore;

...

e) Propozon plotësimin e legjislacionit në fushën e sigurisë kompjuterike dhe merr pjesë në përgatitjen e bazës ligjore për çështjet, që lidhen me fushën e krimit kibernetik;”.

b) Në fund të shkronjës “f” shtohen fjalët “... veçanërisht për çështjet që ndikojnë në sigurinë e fëmijëve që përdorin internetin.”.

c) Pas shkronjës “g” shtohen shkronjat “g”, “h” dhe “i”, me këtë përmbajtje:

“g) Realizon kontrollin periodik të zbatimit të rregullave të sigurisë kompjuterike, të nxjerra sipas shkronjës “d” të kësaj pike, të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet shtetërore, duke përjashtuar ato institucione, sistemet kompjuterike të të cilave u nënshtrohen rregullimeve të veçanta ligjore:

i) Për institucionet që varen nga Kryeministri apo Këshilli i Ministrave, detyrat e kontrollit dhe verifikimit kryhen sipas një grafiku dhe plani pune, të miratuar nga Kryeministri.

ii) Agjencia regjistron në një regjister të veçantë çdo procedurë kontrolli a verifikimi.

h) Mban raportet e ngjarjeve të sigurisë kompjuterike që konstatohen në rrjetet/sistemet kompjuterike shtetërore;

i) Krijon dhe përditëson regjistrin kombëtar të ngjarjeve kompjuterike dhe regjistrin e pikave të kontaktit kombëtar/ndërkombëtar;”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, me këtë përmbajtje:

“3.1 Çdo institucion shtetëror dhe publik detyrohet të caktojë pikat e kontaktit për çështjet e sigurisë kompjuterike dhe të raportojë menjëherë pranë ALCIRT-it për çdo ngjarje që cenon sigurinë në rrjetet/sistemet e tyre kompjuterike.

3.2 Rregullat e sigurisë të nxjerra nga ALCIRT-i, sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të këtij vendimi, publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

3.3 Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) propozon marrjen e masave disiplinore ndaj çdo nëpunësi përgjegjës, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij nuk zbaton rregullat e nxjerra sipas shkronjës “d”, të pikës 3, të këtij vendimi.”.

3. Pika 7 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi